



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

ODA E STOMATOLOGEVE TË KOSOVËS

KOSOVO DENTAL CHAMBER, STOMATOLOSKA KOMORA KOSOVA

RREGULLORE

**PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE, PROCEDURIN E KANDIDIMIT,
MËNYREN E ZGJEDHJES DHE REVOKIMIN E ANËTARËVE TË
ORGANEVE TË ODËS SË STOMATOLOGEVE TË KOSOVËS**

Prishtinë, Tetor 2018

Në bazë të nenit 47 të ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe nenit 19, paragrafi 2, të Statutit të Odës së Stomatologeve të Kosovës, Kuvendi i Odës së Stomatologeve të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 30 nëntor 2018 miraton këtë :

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE, PROCEDURËN E KANDIDIMIT, MËNYRËN E ZGJEDHJES DHE REVOKIMIN E ANËTARËVE TË ORGANEVE TË ODËS SË STOMATOLOGEVE TË KOSOVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e organizimit të zgjedhjeve, organet për organizimin e zgjedhjeve, mënyra e kandidimit, e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të organeve të OSK-së: Kuvendit, Kryetarit të Odës, Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës, Këshillit etik, Gjyqit të Nderit, Prokurorit të Odës, dhe Komisioneve të tjera të përhershme.

ORGANET PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE

Neni 2

1. Organet për organizimin e zgjedhjeve për organet e OSK -së janë:

1.1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Komisioni i Njësisë Zgjedhore (KNJZ).

1.2. KQZ ka 5 anëtarë të emëruar nga Kuvendi i OSK-së. Përparësi në emërimin do të kenë kandidatët të gjinisë femërore anëtarë të OSK-së.

1.3. KNJZ përbëhet nga 3 anëtarë për njësi të emëruar nga KQZ-ja.

1.4. Anëtarët e KQZ emërohen jo më heret 30 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Odës. Anëtari i KQZ-së apo KNJZ-së nuk mund të kandidojë në asnjë organ të OSK-së.

1.5. KQZ mund të akreditojë vëzhguesit nga Oda Stomatologjike të vendeve tjera për monitorimin e procesit zgjedhor.

1.6 KQZ krijon Sekretariatin e KQZ-së, i cili ka për detyrë të mbështet KQZ-në në punën e saj.

Neni 3

1. OSK siguron mjetet e nevojshme për organizimin e zgjedhjeve të destinuara për :

- 1.1. Kompensimi për anëtarët e KQZ-se
- 1.2. Kompenzimin e Sekretariatit
- 1.3. Kompenzimi për anëtarët e KNJZ-se
- 1.4. Shpenzimet e informimit publikë;
- 1.5. Angazhim të personave tjerë për nevojat e procesit zgjedhorë
- 1.6. Sigurimin e materialit zgjedhorë dhe materialeve tjera shpenzuese;
- 1.7. Pajisjet dhe mjetet e nevojshme teknike për organizimin e zgjedhjeve;
- 1.8. Shpenzimet e rrugës, post-telekomunikacionit, etj.

PROCEDURA E KANDIDIMIT DHE ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË ORGANEVE TË OSK-së

1.ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KUVENDIT TË OSK-së

Neni 4

Kuvendi i OSK-së merr vendim për shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e OSK-së, jo më vonë se 30 ditë nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 5

KQZ, ndërmerrë të gjitha veprimet për përgaditjet dhe mbajtjen e zgjedhjeve.

Neni 6

1. Anëtarët e Kuvendit të OSK zgjedhën me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë të përcaktuara nga KQZ, në shtatë (8) njësi zgjedhore.
2. Njësitë zgjedhore për Kuvendin e OSK-së janë:
 - 2.1. **Regjioni i Prishtinës** (Prishtinë, Fushë Kosovë, Podujevë, , Lipjan, Obiliq, Graçanicë);
 - 2.2. **Regjioni i Prizrenit** (Prizren, Suharekë, , Dragash, Malishevë, Mamushë);
 - 2.2. **Regjioni i Pejës** (Pejë, Klinë, Istog);
 - 2.4. **Regjioni i Gjilanit** (Gjilan, Kamenica, Vitia, Novobërda, Klllokot, Partesh, Ranilluk);
 - 2.5. **Regjioni i Mitrovicës** (Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Mitrovica e Veriut, Drenas, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok);
 - 2.6. **Regjioni i Gjakovës** (Gjakovë, Deçan , Rahovec, Junik);
 - 2.7. **Regjioni i Ferizajt** (Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpçë, Hani i Elezit);
 - 2.8. **QKUSK dhe KMF**

Neni 7

1. Kuvendi I Odes ka deri 55 anetar (i shtohen edhe 2 nga komunineti joshumicë).
2. Numri I anetareve te Kuvedit nga Regjionet percaktohet duke pjestuar numrin e anetareve te regjistruar ne Ode me numrin e anetareve te Kuvedit

Neni 8

1. Me qëllim të formimit më të lehtë të njësisë zgjedhore shmangiet nga kriteret e numrit të Stomatologeve të regjistruar mund të jenë $\pm 5 \%$.

Procedura e kandidimit Neni 9

1. Për anëtarë të Kuvendit të OSK-së mund të propozohet dhe zgjidhet çdo anëtarë i regjistruar në regjistrin e anëtarëve të OSK-së deri me date 30 Qershor 2018.
2. Kandidate me licenca valide por te cilet nuk jane anetarsuar ne Ode deri me date te percaktuar sipas paragrafit 1 te ketij neni.
3. Kandidatin për anëtarë të Kuvendit të OSK-së mund ta propozojë çdo anëtarë i regjistruar në regjistrin e anëtarëve të OSK-së deri me datën e cekur me larte si dhe stomatologët me Licenca valide të lëshuara nga MSH.

Nen 10

1. Secila kandidaturë për anëtarë të Kuvendit të OSK-së duhet të mbështetet me nënshkrimet e së paku 5 anëtarëve të OSK-së nga njësia zgjedhore ku ushtron veprimtarine.
2. Njësia zgjedhore përcaktohet në bazë të vendit ku kandidati ushtron veprimtarinë dhe vërtetohet me Vërtetim nga punëdhënësi ose kopja e Tatimit në burim për 2 muaj të fundit nga ATK
3. Një anëtarë i OSK-së mund të mbështes vetëm një kandidatë për anëtarë të Kuvendit.

Neni 11

Pas përfundimit të procedurës së kandidimit, KQZ përcakton listën përfundimtare të kandidatëve dhe i publikon në faqen zyrtare për secilin regjion.

Neni 12

Zgjedhjet për anëtarë të Kuvendit të OSK mbahen në vendvotimin e përcaktuar nga KQZ-ja.

Neni 13

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka për obligim që me kohë të përgaditë dhe të distribuon tërë materialin zgjedhorë duke përfshirë fletëvotimet, ekstraktin e votuesve dhe vendvotimit, fletëvotimet, procesverbalet dhe shkresat tjera.

Neni 14

1. Votimi është personal dhe bëhet në fletëvotim, duke shenjëzuar emrin e kandidatit

që zgjidhen në Kuvendin e Odës.

2. Votuesi ka të drejtë të votojë vetëm për 1 kandidatë.
3. Fletëvotimi përmban : Numrin rendorë, emrin dhe mbiemrin e kandidatëve të renditur sipas alfabetit.

Neni 15

Fletëvotimet e pa plotësuara, fletëvotimet në të cilat janë rrumbullakuar numrat rendorë të emrave të më shumë se një kandidati, dhe fletëvotimet ku nuk mund me saktësi të vërtetohet se për cilin kandidatë është votuar konsiderohen të pa vlefshme.

Neni 16

1. Votimi në vendvotim fillon në ora 8 dhe përfundon në ora 19.
2. Në rast se në vendvotim kanë votuar të gjithë votuesit e regjistruar vendvotimi mund të mbyllet edhe para orës 19.
3. Gjatë tërë kohës së votimit anëtarët e KNJZ-së duhet të jenë prezentë dhe të kujdesen për mbajtjen e rendit në hapësirën ku mbahet votimi.

Neni 17

Secili votues duhet të identifikohet nga KNJZ duke prezantuar kartën identifikuese, apo

dëshmi tjera të pranueshme të caktuar nga KQZ-ja me të cilat vërtetohet autenticiteti i votueseve.

Përcaktimi dhe shpallja e rezultateve të votimit Neni 18

1. Pas përfundimit të afatit për votim KNJZ , shpall rezultatet preliminare të zgjedhjeve.
2. Paraprakisht në bazë të regjistrit të votuesve përcakton numrin e përgjithshëm të votuesve që kanë votuar dhe pastaj bën hapjen e kutisë të cilat i krahason me numrin e pa përdorur të fletëvotimeve dhe konstaton numrin e saktë të votuesve.
3. Pas përfundimit të numërimit komisioni konstaton numrin e votave për secilin kandidat në bazë të renditjes në fletëvotim dhe numrin e fletëvotimeve të pavlefshme.

Neni 19

1. KNJZ pas numërimit të të gjitha fletëvotimeve plotëson procesverbalin i cili duhet të përmbajë: numrin e tërësishëm të votuesve sipas regjistrit të votuesve, numrin e votuesve që kanë votuar, numrin e votave që ka fituar secili kandidatë sipas numrit rendorë në fletëvotim dhe numrin e fletëvotimeve të pavlefshme.
2. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KNJZ-së.

Neni 20

1. Procesverbalet së bashku me materialin tjetër zgjedhorë i dorëzohen KQZ-së më së voni 12 orë nga mbyllja e vendvotimit.
2. KQZ duhet ti shpall rezultatet preliminare 4 orë pas marrjes së procesverbaleve së bashku me materialin tjetër zgjedhor.

Neni 21

KQZ në afat prej 5 ditësh nga mbajtja e tyre shpallë rezultatet përfundimtare për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit të OSK-së

Neni 22

Mandati i anëtarëve të Kuvendit të OSK zgjatë 4 vite dhe fillon të rrjedhë nga dita e certifikimit të rezultateve nga KQZ.

Ankimimi në procesin

zgjedhor Neni 23

1. Kandidati për anëtarë të Kuvendit të OSK-së mund të parashtrojë ankesë nëse konsideron se ka pasur parregullsi në procesin zgjedhorë.
2. Ankesa i parashtrohet KNJZ në afat prej 24 orësh nga publikimi rezultateve preliminare, nga KNJZ-ja.
3. Komisioni njësisë zgjedhore ka për obligim që në afat prej 12 orësh nga dita e pranimit të ankesës ti kthejë përgjigje me shkrim ankuesit .
4. Kandidati i pakënaqur me vendimin e KNJZ-së në afat prej 24 orë mund të bëjë ankesë komisionit qendrorë zgjedhorë
5. KQZ në afat prej 12 orësh, përgjigjet ankuesit në ankesen e tij.

Procedura e

Revokimit

Neni 24

Me kërkesën e së paku 1/3 të anëtarëve të Odës të njësisë përkatëse zgjedhore në të cilën anëtari i Kuvendit të OSK-së është zgjedhur, Kuvendi i OSK-së obligohet që në afat prej 45 ditësh të fillojë procedurën e deklarimit të besimit të anëtarit të zgjedhur.

Neni 25

1. Konsiderohet se anëtari i Kuvendit të OSK-së është i revokuar nëse për revokimin e tij kanë votuar më shumë se gjysma e anëtarëve të OSK-së në njësinë përkatëse

zgjedhore.

2. Në rast revokimi Kuvendi i OSK-së duhet të fillojë procedurën e zëvendësimit të të njëjtit me anëtarin e parë në renditje me më shumë vota në afat prej 45 ditësh nga dita e votimit.
3. Nëse një anëtarë i zgjedhur në Kuvendin e OSK-së nuk ushtron funksionin e tij sipas statutit, dhe rregullores mbi punën e Kuvendit të OSK-së, dhe nuk merr pjesë së paku në 3 mbledhje të Kuvendit të OSK-së, si dhe nuk arsyeton mungesën, KQZ do të njoftojë njësin zgjedhore se të njëjtit i ka pushuar mandati dhe të bëjë përzgjedhjen e anëtarit sipas radhës së renditjes së listës së kandidatëve nga njësia zgjedhore.

Neni 26

1. Anëtarit të revokuar të njësisë përkatëse zgjedhore i pushon anëtarësimi në komisionet dhe organet e OSK-së

2. ZGJEDHJA E KRYETARIT DHE ZV. KRYETARIT TË

ODËS Neni 27

1. Pas certifikimit të rezultateve për anetarë të Kuvendit të OSK, KQZ-ja shpall procesin e kandidimit për kryetarë të OSK-së. Afati për kandidim është 7 ditë nga dita e shpalljes së procesit zgjedhorë për kryetarë.
2. Secila kandidaturë për kryetarë të OSK-së duhet të mbështetet me nënshkrimet e 5 anëtarëve të Kuvendit të OSK.
3. Kandidatura në formë të shkruar i dorëzohet KQZ-së e cila përcakton listën përfundimtare të kandidatëve për Kryetarë të OSK-së.

Neni 28

Jo më vonë se 7 ditë nga certifikimi i kandidaturave për Kryetar të OSK-së, ftohet mbledhja konstituive e Kuvendit, në të cilën zgjedhet Kryetari i OSK-së

Neni 29

1. Votimi për kryetarë të OSK-së bëhet me votë të fshehtë.

2. Konsiderohet se është zgjedhur kandidati i cili ka fituar më së shumti vota, me kusht që për të të votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të Kuvendit.
3. Në rast se asnjëri kandidatë nuk ka fituar mbi gjysmën e votave të anëtarëve të Kuvendit, dy kandidatët me numrin më të madh të votave do të kualifikohen për rundin e dytë të votimit.
4. Në rundin e dytë të votimit konsiderohet së është zgjedhur kandidati që ka fituar më shumë vota nga anëtarët e kuvendit.
5. Kandidati për kryetar të OSK-së duhet ti plotësojë kushtet e parapara në Statut në nenin 25 paragrafi 1.

Neni 30

1. Me propozim të Kryetarit të OSK-së, Kuvendi me shumicë votash të anëtarëve prezent zgjedh zv.Kryetarët duke e respektuar Nenin 25, paragrafi 2 dhe 3
2. Votimi bëhet në mënyrë të hapur.

3. ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT

DREJTUES Neni 31

1. Jo më vonë se 30 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OSK-së bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Odës.
2. Kryetari dhe zv. Kryetarët e OSK-së janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.
3. Kandidatura për anëtarë të Këshillit Drejtues duhet të mbështet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit . Votimi për anëtarë të Këshillit Drejtues është i drejtpërdrejt dhe i fshehtë. Një anëtar i kuvendit të OSK-së mund të votojë vetëm një kandidatë për anëtarë të Këshillit Drejtues.
4. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohet në KQZ.
5. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota, zgjidhen anëtarë të Këshillit Drejtues.

4. ZGJEDHJA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË ODËS

Neni 32

1. Jo më vonë se 30 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OSK-së bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
2. Këshilli mbikëqyrës i OSK-së ka kryetarin dhe 4 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OSK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OSK-së.
4. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
5. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota, zgjidhen anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.
6. Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës zgjidhet kandidati i cili është votuar më së shumti vota.

5. ZGJEDHJA E KËSHILLIT

ETIK Neni 33

1. Jo më vonë se 30 ditë nga dita e konstituimit të Këshillit Drejtues dhe Mbikëqyrës, bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Etik të OSK-së.
2. Këshilli Etik ka Kryetarin dhe 4 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OSK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për anëtarë të Këshillit Etik duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OSK.
4. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
4. Kryetari i Këshillit Etik zgjidhet kandidati i cili është votuar më së shumti vota.
4. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota, zgjidhen anëtarë të Këshillit Etik.

6. ZGJEDHJA E GJYQIT TË NDERIT

Neni 34

1. Jo më vonë se 45 ditë nga dita e konstituimit të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikqyrës bëhet zgjedhja e anëtarëve të Gjyqit të Nderit.
2. Gjyqi i Nderit ka 5 anëtarë, Kryetarin, Zv.kryetarin dhe 3 anëtarë.
3. Një anëtarë i gjyqit të nderit zgjedhet nga kuvendi nga lista e propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
4. Kandidati për anëtarë të Gjyqit të Nderit duhet të mbështet nga 5 antarë të Kuvendit të OSK- së.
5. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
6. Kryetari i Këshillit Mbikqyrës zgjidhet kandidati i cili është votuar më së shumti vota.
7. Votimi është i drejtpërdrejtë dhe i fshehtë.
8. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota, zgjidhen anëtarë të Gjyqit të Nderit.

7. ZGJEDHJA E PROKURORIT TË ODËS

Neni 35

1. Jo më vonë se 45 ditë nga dita e konstituimit Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikqyrës të OSK bëhet zgjedhja e Prokurorit.
2. Prokurori dhe Zv.prokurori zgjedhën nga Kuvendi i OSK-së nga radha e anëtarëve të odës në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për Prokurorë të Odës duhet të mbështet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të Odës, ndërsa për Zv.prokurorë nga 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të Odës.
4. Votimi është i drejtpërdrejtë dhe i fshehtë.

5. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota, zgjidhen pPokurorë dhe zv. Prokurorë.

8. ZGJEDHJA E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË ODËS

Neni 36

1. Komisionet e Përhershme të odës

janë : 1.1.Komisioni për çështje
etike; 1.2.Komisioni për licencim;

1.3.Komisioni për edukim
specialistik;

1.4.Komisioni për edukim të vazhdueshëm
profesional; 1.5.Komisioni për buxhet dhe
financa;

1.6.Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.

Neni 37

1. Komisionet nga neni paraprak kanë nga 7 anëtarë nga radhët e të cilëve zgjidhet kryesuesi dhe Zv. kryesuesi i komisionit.

2. Kandidatura për anëtarë të komisioneve të përhershme duhet ti propozohet kuvendit të OSK- së për votim nga Këshilli Drejtues.

Neni 38

Fushëveprimi i komisioneve të përhershme përcaktohet me akte të veçanta normative të miratuara nga Kuvendi i OSK-së.

Neni 39

Organet e OSK-së nga përbërja e kaluar e Kuvendit, vazhdojnë punën deri në konstituimin e organeve nga përbërja e re e Kuvendit.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 40

Kjo rregullore hyn ne fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i OSK-së.

Kryetari i OSK-së

Prof. Dr. Kujtim Shala



Prishtinë 30 tetor 2018